



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.681/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), me panelin e përbërë nga gjyqtarët: Rrustem Thaqi kryesues, Faton Ademi dhe Ferki Xhaferi anëtar, duke vendosur përkitazi me ankesën e Zeqir Hasi nga radhët e Subjektit Politik Partia Demokratike e Kosovës, dega në Glllogoc, të paraqitur kundër Komisioni Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me objekt të çështjes verifikim i rezultateve në vendvotimin, për Zgjedhjet lokale të datës 17 tetor 2021. Në seancën e panelit të mbajtur më datë 20.10.2021, mori këtë:

V E N D I M

HUDHET e palejuar ankesa Anr.681/2021 e datës 18.10.2021, e paraqitur nga Zeqir Hasi kandidat për Kuvend Komunal në Glllogoc nga radhët e Partisë Demokratike të Kosovës, kundër Komisioni Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të verifikimit të rezultateve në vendvotimin, nr.0311e\01R, 0311e\02r, 0311e\03D në Drenas për Zgjedhjet Lokale 2021, të datës 17.10.2021.

A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 18.10.2021, ka pranuar një ankesë Anr.681/2021 nga Zeqir Hasi kandidat për Kuvend Komunal nga radhët e Partisë Demokratike të Kosovës, në të cilën theksohet se në Qendrën e votimit ne Sankoc ka shkelje duke devijuar votat për kandidat për kuvend komunal gjatë numërimit të votave. Për këto shkelje ka ofruar deklaratat e familjes së tij ku secili prej tyre ka votuar por pas numërimit të votave nuk kanë figuruar votat. Duke cekur edhe emrat e personave dëshmitar që kanë votuar, Brahim Rama, Qëndrim Rama, Lulzim Rama.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi lejueshmërinë e ankesës, gjeti se:

Ankesa është e palejuar

Paneli nuk është lëshuar fare në vlerësimin e pretendimeve ankimore, lidhur me shkeljet e pretenduar në ankesë përkitazi me parregullsitë në vendvotimin me nr.0311e\01R, 0311e\02r, 0311e\03D në Glllogoc, për faktin se shkeljet që ndërlidhen me rezultatin e votimit, duhet të parashtrohen me rastin e shpalljes së rezultatit përfundimtar nga KQZ-ja, e jo në këtë fazë të procesit zgjedhor. Në rastin konkret nga KQZ-ja, nuk është marrë vendimi përfundimtar mbi shpalljen e rezultatit përfundimtar, andaj Paneli vendosi që ta hudhë si të parakohshme ankesën e ankuesit. Hudhja e ankesës së Zeqir Hasi nuk e paragjykon çështjen dhe ankueses nuk i mohohet e drejta që mbi këtë bazë, të paraqes ankesa tjera, pas shpalljes të rezultatit përfundimtar nga KQZ-ja.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lartë, e në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

A nr. 681/2021 më datën 20.10.2021

Kryesuesi i Paneli

Rrustem Bhaqi



Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.*